

## Çfarë është papilloma virus(HPV) ?

Infektimi nga HPV është infeksioni më i përhapur nëpërmjet trasmetimit seksual edhe kur raportet nuk janë të plota. Prezervativi, që duhet përdorur gjithmonë, nuk garanton një mbrojtje të plotë kundër këtij virusi. **Rreth 75% e personave hyjnë në kontakt me këtë virus të paktën një herë në jetë.**

**Disa lloje të HPV mund të provokojnë të çara që, dalëngadalë, mund të transformohen në forma tumori të qafës së mitrës.** Virusi HPV është në fakt përgjegjës i tumorigjenit në qafën e mitrës, i pari tumor i njohur nga Organizata Ndërkombëtare e Shëndetësisë si tumori totalisht me prejardhje nga një infeksion.

## Përse është i rekomandueshëm vaksinimi ?

Sepse kjo vaksinë pengon tumorin në qafën e mitrës, të shkaktuar në **rreth 75% të rasteve nga papilloma virus në hallkat "16" e "18"**. Efektet anësore që mund të manifestohen pas vaksinimit (skuqje e lehtë e zonës ku injektohet e ndonjëherë dhe pak temperaturë) janë efekte të lehta e përgjithësisht zgjatin pak.

## Kujt i drejtohet vakcina ?

I drejtohet të gjitha vajzave, duke filluar nga mbushja e 11 vjeteve.

## Përse ky vaksinim në moshë kaq të re ?

Sepse forca e imunitetit në këtë moshë është më e madhe, për rrjedhojë përfitimi nga vakcina është në maksimum. Përveç kësaj, **vakcina është më e efektshme nëse kryhet përpara fillimit të aktivitetit seksual sepse garanton mbrojtje më të madhe përpara infektimit të mundshëm nga virusi HPV.**

## Kush përfiton vaksinën falas ?

Vakcina është komplet gratis për të gjitha vajzat banuese në Toskanë, **nga mosha 11 vjeç të mbushura, deri në 18 vjeç të pambushura.**

## Si është e përbërë vakcina ?

Janë të parashikuara tre injeksione muskulare (në krah) të cilat kryhen në harkun kohor të 6 muajve.

## Vakcina zëvendëson screening periodic (Pap Test) ?

**Jo, vakcina nuk zëvendëson kontrollin periodik për tumorin e qafës së mitrës (Pap Test) por integrohet me programet e diagnostikimit të parakohshëm (Pap Test e të tjera).**

## Ku kryhet vaksinimi ?

**Në qendrat e vaksinimit të ndërmarrjeve USL të Toskanës,** ku si vajzat ashtu dhe prindërit e tyre mund të marrin të gjithë informacionin e duhur.

## Për të ditur më shumë

Të gjitha informacionet mbi programin e vaksinimit kundër Papilloma Virus (**HPV**) janë të konsultueshme në sitin rajonal [www.regione.toscana.it/iointantomivaccino](http://www.regione.toscana.it/iointantomivaccino). Mund të telefononi në numrin jeshil rajonal **556060** (falas) ose të drejtoheni në Zyrën e Mardhënieve me Publikun të Ndërrmarjeve Shëndetësore të Toskanës.

Azienda sanitaria	Telefono	Azienda sanitaria	Telefono
AUSL 1 Massa Carrara	800 565509	AUSL 8 Arezzo	0575 254000
AUSL 2 Lucca	800 869143	AUSL 9 Grosseto	800 320651
AUSL 3 Pistoia	800 861213	AUSL 10 Firenze	840 003003
AUSL 4 Prato	800 017835		numër fiks
AUSL 5 Pisa	0587 273090		199 175955
AUSL 6 Livorno	800 030808	AUSL 11 Empoli	0571 7051
AUSL 7 Siena	0577 767777	AUSL 12 Viareggio	800 297211



[www.regione.toscana.it/iointantomivaccino](http://www.regione.toscana.it/iointantomivaccino)

**Për vajzën tënde që rritet  
më mirë vaksina sot  
se l'hpv nesër**

**Është një mbrojtje  
e rëndësishme  
E rëndësishme  
të vaksinohesh në kohën  
e duhur**

